

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar i Avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 23.9.2023

1. Viking sh.a është një biznes shumë i suksesshëm që operon në Kosovë dhe ka investime në dy kompani të tjera. Pasqyrat e mëposhtme të pozitës financiare më 31 dhjetor 2022 të Viking sh.a dhe kompanive në të cilat ka investuar janë si në vijim:

|                                     | Viking sh.a<br>€'milion | Rosetta sh.a<br>€'milion | MAVEN sh.a<br>€'milion |
|-------------------------------------|-------------------------|--------------------------|------------------------|
| <b>Pasuritë</b>                     |                         |                          |                        |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>     | 1,024                   | 352                      | 224                    |
| Investimet në Rosetta sh.a          | 320                     | -                        | -                      |
| Investimet në MAVEN sh.a            | 48                      | -                        | -                      |
| <i>Pasuritë qarkulluese:</i>        | <u>435</u>              | <u>152</u>               | <u>104</u>             |
| <b>Total pasuritë</b>               | <b>1,827</b>            | <b>504</b>               | <b>328</b>             |
| <i>Ekuiteti dhe detyrimet:</i>      |                         |                          |                        |
| Kapitali aksionar                   | 760                     | 208                      | 184                    |
| Rezerva e rivlerësimit              | 72                      | -                        | -                      |
| Fitimet e mbajtura                  | <u>312</u>              | <u>168</u>               | <u>75</u>              |
| Total ekuiteti                      | 1,144                   | 376                      | 259                    |
| <i>Detyrimet afatgjata</i>          | 512                     | 24                       | 13                     |
| <i>Detyrimet afatshkurtra</i>       | <u>171</u>              | <u>104</u>               | <u>56</u>              |
| <b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b> | <b>1,827</b>            | <b>504</b>               | <b>328</b>             |

Informatat shitesë të mëposhtme janë të rëndësishme për pasqyrën financiare të konsoliduar të Viking sh.a:

- i) Më 1 janar 2020, Viking sh.a bleu 10% të aksioneve të Rosetta sh.a kur vlera e drejtë e pasurive neto ishte €260 milionë për një shumë prej €24 milionë. Më 1 janar 2022, Viking sh.a bleu edhe 70% të tjera të aksioneve në Rosetta sh.a kur vlera e drejtë e pasurive neto ishte €368 milion për një shumë prej €296 milion.
- ii) Vlera e drejtë e vlerësuar e investimit fillestar prej 10% në aksionet e Rosetta sh.a ishte €32 milion më 31 dhjetor 2021.
- iii) Viking sh.a dëshiron të përdorë metodën e kontabilitetit të vlerës së drejtë të plotë për blerjen e Rosetta sh.a. Më 1 janar 2022, vlera e vlerësuar e interesave jo-kontrolluese ishte €76 milion.
- iv) Diferenca midis vlerës kontabël të pasurive neto të Rosetta sh.a dhe vlerës së drejtë të tyre në datën e blerjes ishte për shkak të tokës së vlerësuar me kosto e cila më 1 janar 2022 kishte një vlerë të drejtë prej €20 milion më shumë se vlera e saj kontabël. Nuk ka pasur asnjë ndryshim të mëvonshëm të rëndësishëm në atë vlerë.
- v) Më 1 janar 2022, Viking sh.a bleu 25% të aksioneve në MAVEN sh.a kur vlera e drejtë e pasurive neto ishte €160 milion për një shumë prej €48 milion.
- vi) Më 1 janar 2022, vlera e drejtë e tokës së MAVEN sh.a ishte €13 milion më shumë se vlera kontabël e saj. Nuk ka pasur asnjë ndryshim të mëvonshëm të rëndësishëm në atë vlerë.

- vii) Zëri i mirë që lind nga blerja testohet për dëmtim në fund të çdo viti. Shuma e rikuperueshme e zërit të mirë në Rosetta sh.a më 31 dhjetor 2022 ishte €24 milion. Nuk ka pasur dëmtim të investimit në MAVEN sh.a.
- viii) Gjatë vitit, Drejtorët e Viking sh.a vendosën të formojnë një skemë pensioni me përfitime të paracaktuara për punonjësit e saj. Kompania ka kontribuar me para të gatshme në vlerë prej €200 milionë në skemë, por e vetmja hyrje kontabël për këtë ka qenë përfshirja e saj në të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022. Më 31 dhjetor 2022, detajet e mëposhtme kanë të bëjnë me skemën e pensioneve:

|                                             |          |
|---------------------------------------------|----------|
|                                             | € milion |
| Vlera e tanishme e obligimit të paracaktuar | 253.6    |
| Vlera e drejtë e pasurive të planit         | 241.6    |

**Kërkohet:**

**Përgatitni Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare të grupit Viking më 31 dhjetor 2022.** (20 pikë)

1.

## Grupi Viking

## Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2022

€'milion

**Pasuritë**

|                                        |                    |              |
|----------------------------------------|--------------------|--------------|
| Pasuritë jo-qarkulluese                | (1,024+352+20 L12) | 1,396        |
| Zëri i mirë (L13)                      |                    | 24           |
| Investimet në ortakëri (L16)           |                    | <u>76</u>    |
|                                        |                    | 1,496        |
| Pasuritë qarkulluese (435+152-200 L17) |                    | <u>387</u>   |
| <b>Total pasuritë</b>                  |                    | <b>1,883</b> |

## Ekuiteti dhe detyrimet

|                                                 |              |
|-------------------------------------------------|--------------|
| Kapitali aksionar                               | 760          |
| Rezerva e rivlerësimit                          | 72           |
| Fitimet e mbajtura (L15)                        | 148.8        |
| Interesat jo-kontrollues (L14)                  | <u>79.2</u>  |
| Total ekuiteti                                  | 1,060        |
| Detyrimet afatgjata (512+24+12 pensionet (L17)) | 548          |
| Detyrimet afatshkurtra (171+104)                | <u>275</u>   |
| Total detyrimet                                 | <u>823</u>   |
| <b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>             | <b>1,883</b> |

**Llogaritjet****1. Srtuktura e grupit**

|              |                |               |                  |
|--------------|----------------|---------------|------------------|
|              | Viking sh.a    |               |                  |
|              | 80%            |               | 25%              |
|              | Rosetta sh.a   |               | MAVEN sh.a       |
|              | (1 vit filial) |               | (1 vit ortakëri) |
|              | Blerja e parë  | Blerja e dytë | Total            |
| Rosetta sh.a | 10%            | 70%           | 80%              |
| MAVEN sh.a   | 25%            | -             | 25%              |

**2. Levizjet në pasuritë neto**

|                                    |                   |                |                         |
|------------------------------------|-------------------|----------------|-------------------------|
|                                    | Data e raportimit | Data e blerjes | €'milion<br>Pas blerjes |
| Rosetta sh.a                       |                   |                |                         |
| Kapitali aksionar                  | 208               | 208            | -                       |
| Fitimet e mbajtura (368 - 208 -20) | 168               | 140            | 28                      |
| Korigjim i VD - toka               | <u>20</u>         | <u>20</u>      | <u>-</u>                |
|                                    | 396               | 368            | 28                      |
| MAVEN sh.a                         |                   |                |                         |
| Kapitali aksionar                  | 184               | 184            | -                       |
| Fitimet e mbajtura (160 -13 - 184) | 75                | (37)           | 112                     |
| Korigjim i VD - toka               | <u>13</u>         | <u>13</u>      | <u>-</u>                |
|                                    | <b>272</b>        | <b>160</b>     | <b>112</b>              |

|                                                                            |                                        |     |
|----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|-----|
| <b>3. Zëri i mirë – Rosetta sh.a</b>                                       | <b>€'milion</b>                        |     |
| Kosto e investimit (32+296)                                                | 328                                    |     |
| VD e IJK-së në blerje                                                      | <u>76</u>                              |     |
|                                                                            | 404                                    |     |
| VD e pasurive neto të identifikueshme të blera (L12)                       | <u>(368)</u>                           |     |
| Zëri i mirë në blerje                                                      | 36                                     |     |
| Dëmtimi (shif. bal)                                                        | <u>(12)</u>                            |     |
| Zëri i mirë i rishikuar (shuma e rikuperueshme)                            | 24                                     |     |
| <b>4. Interesat jo-kontrollues – Rosetta sh.a</b>                          | <b>€'milion</b>                        |     |
| VD e IJK-së në blerje                                                      | 76                                     |     |
| Plus: IJK% e Rosetta sh.a's pas blerjes (20% x 28)                         | 5.6                                    |     |
| Minus: IJK% e dëmtimit (20% x 12)                                          | <u>(2.4)</u>                           |     |
|                                                                            | 79.2                                   |     |
| Në mënyrë alternative:                                                     |                                        |     |
| Vlera në libra (20% x 376)                                                 | 75.2                                   |     |
| Korrigjimet e VD (20% x 20)                                                | 4                                      |     |
| Zëri i mirë (76 – (20% x 368) – dëmtimi (2.4))                             | <u>(0)</u>                             |     |
|                                                                            | 79.2                                   |     |
| <b>5. Fitimet e mbajtura</b>                                               | <b>€'milion</b>                        |     |
| Viking sh.a                                                                |                                        |     |
| Saldo në fillim                                                            | 312                                    |     |
| Fitimi i vlerës së drejtë nga rimatja e pronesisë prej 10% (32-24)         | 8                                      |     |
| Shpënzimet e pensioneve (L17)                                              | <u>(212)</u>                           |     |
| Rosetta sh.a                                                               |                                        |     |
| Pjesa e prindit në fitimet pas blerjes (80% x 28)                          | 22.4                                   |     |
| Dëmtimi (80%x12)                                                           | <u>(9.6)</u>                           |     |
| MAVEN sh.a                                                                 |                                        |     |
| Pjesa e prindit në fitimet pas blerjes (25% x 112)                         | <u>28</u>                              |     |
|                                                                            | 148.8                                  |     |
| <b>6. Investimet në ortakëri</b>                                           | <b>€'milion</b>                        |     |
| Kosto e investimit                                                         | 48                                     |     |
| Plus: pjesa e fitimit                                                      | <u>28</u>                              |     |
|                                                                            | 76                                     |     |
| <b>7. Pensionet</b>                                                        | <b>€'milion</b>                        |     |
| Lëvizjet neto të detyrimeve të pensioneve:                                 |                                        |     |
| Saldo në fillim                                                            | -                                      |     |
| Kontributet në skemë *                                                     | <u>(200)</u>                           |     |
| Shpenzimet e kombinuara të pensioneve (shif. bal.)                         | <u>212</u>                             |     |
| Saldo në fund (253.6-241.6)                                                | 12                                     |     |
| * Kërkohet korrigjim për postimin e gabuar në llogarinë e të arkëtueshmeve |                                        |     |
| Debi                                                                       | Neto detyrimet e pensioneve            | 200 |
| Kredi                                                                      | Të arkëtueshmet (pasuritë qarkulluese) | 200 |

2.

a) Me 1 janar 2021, Yinghuo-1 sh.a akordon kontrata me mundësi zgjedhjeje për aksione [opshëns] për secilin prej 100 punonjësve të tij.

Kontratat me mundësi zgjedhjeje për aksione do të përfitojnë titullin me 31 dhjetor 2023. Përfitimi i titullit është i kushtëzuar me dy kushte:

– Punonjësit duhet të punojë për Yinghuo-1 sh.a deri me 31 dhjetor 2023.

– Të ardhurat nga shitjet e Yinghuo-1 sh.a rriten me një shumë kumulative prej të paktën 40% në periudhën trevjeçare që përfundon më 31 dhjetor 2023 (shih tabelen më poshtë).

**Rritja kumulative e të hyrave në periudhën tre vjeçare**

**Numri i kontratave që i takon secilit punonjës (varësisht nga përmbushja e kushteve)**

Ndërmjet 40% dhe 50%

100

Mbi 50%

150

Më 1 janar 2021, vlera e drejtë e një kontrate me mundësi zgjedhjeje për aksione ishte €6.80. Kjo ishte rritur në €7.50 me 31 dhjetor 2021 dhe në €8.0 deri më 31 dhjetor 2022. Gjatë dy (2) viteve të përfunduara më 31 dhjetor 2022, pritshmëritë për rritjen e të ardhurave dhe mbajtjen e punonjësve në periudhën trevjeçare që përfundon më 31 dhjetor 2023 ndryshuan si në vijim:

| Rritja e të hyrave      |             |                                                  | Punonjës që kanë lënë punën |             |                                                                               |
|-------------------------|-------------|--------------------------------------------------|-----------------------------|-------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| Viti deri me 31 dhjetor | Gjatë vitit | Rritja kumulative e pritshme përgjatë tre viteve | Viti deri me 31 dhjetor     | Gjatë vitit | Numri i punonjësve të tjerë që pritet të lënë punën për periudhën tre vjeçare |
| 2021                    | 18%         | 45%                                              | 2021                        | 12          | 23                                                                            |
| 2022                    | 22%         | 55%                                              | 2022                        | 8           | 16                                                                            |

Ju mund të supozoni se ky transaksion është kontabilizuar saktë nga Yinghuo-1 sh.a në pasqyrat e saj financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni se si duhet të kontabilizohen kontratat me mundësi zgjedhjeje (opcionet) e aksioneve në pasqyrat financiare të Yinghuo-1 sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022. (10 pikë)**

b) Ingenuity sh.a operon në industrinë e elektroteknike dhe blen produkte të ndryshme elektroteknike, të cilat ua dorëzon shitësve të ndryshëm në rrjetin e saj të shpërndarjes brenda Kosovës.

Ingenuity sh.a ofron garancion për një nga produktet e saj, Hope, për shitësit me pakicë. Ingenuity sh.a u kthen shitësve çmimin e plotë të shitjes për njësitë e Hope, të cilat klientët përfundimtarë ua kthejnë shitësve me pakicë brenda një viti pas datës së blerjes nese klienti nuk ishte plotësisht i kënaqur. Rrjedhimisht, Ingenuity sh.a ka marrë një polisë sigurimi për t'u siguruar nga kostoja e plotë e rimbursimeve për shitësit me pakicë. Garancioni filloi më 1 janar 2021. Shitjet totale për Hope ishin 2 milionë njësi në vitin deri më 31 dhjetor 2021 dhe 3 milionë njësi në vitin deri më 31 dhjetor 2022. Në të dy vitet, çmimi mesatar për njësi të Hope ishte €1.80. Probabiliteti që një njësi e një Hope të kthehet u vlerësua fillimisht në 10%, por u

rishikua në vetëm 8% gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2022. Nga totali i shitjeve gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2021, 50,000 njësi u kthyen gjatë atij viti por brenda periudhës së garancisë. Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2022, 20,000 njësi janë kthyer në lidhje me shitjet gjatë së njëjtës periudhë, të gjitha brenda periudhës së garancisë. Të gjitha kundër-kërkesat nga kompania e sigurimit në lidhje me dëmet gjatë dy viteve deri më 31 dhjetor 2022 janë rimbursuar plotësisht.

**Kërkohet:**

**Shpjego shkurtimisht se si duhet të raportohet skema e garancionit të Ingenuity sh.a-së në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022. (10 pikë)**

## 2. (a)

Kostoja totale e pritshme e skemës me 31 dhjetor 2021 ishte €44,200  $(100 - 12 - 23) \times 100 \times €6.80$ .

Kostoja kumulative e njohur deri me 31 dhjetor 2021 do të kishte qenë €14,733.33  $(€44,200 \times 1/3)$ .

Kostoja totale e pritshme e skemës me 31 dhjetor 2022 është €65,280  $(100 - 12 - 8 - 16) \times 150 \times €6.80$ .

Kostoja kumulative e njohur deri me 31 dhjetor 2022 është €43,520  $(€65,280 \times 2/3)$ .

Shuma e ngarkuar si shpenzim shpërblimi në fitim ose humbje për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 do të jetë €28,786.67  $(€43,520 - €14,733.33)$ .

## b)

Çështja është nëse Ingenuity sh.a duhet të njohë një detyrim në lidhje me pretendimet e garancionit nga shitësit me pakicë.

Shuma në të cilën një provizion duhet të njihet bazohet në kërkesat e SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Pasuritë Kontingjente*. SNK 37 kërkon që një entitet duhet të njohë një provizion vetëm nëse plotësohen tre kritere:

1. Ekziston një detyrim ekzistues ose aktual për të transferuar përfitime ekonomike në të ardhmen.
2. Është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme do të transferohen.
3. Shuma mund të matet në mënyrë të besueshme

Në këtë rast, detyrimi lind nga premtimi për të rimbursuar kthimet në lidhje me transaksionet që tashmë janë kryer, prandaj kriteri 1 më sipër plotësohet. Megjithëse probabiliteti i kthimit të njësive individuale është më pak se i mundshëm, ka të ngjarë që disa njësi nga totali i shitjeve të kthehen. Kriteri 2 i mësipërm, pra, plotësohet. Shuma e provizionit mund të bazohet në numrin e pritur të njësive që do të kthehen. Duke supozuar se probabilitetet e vlerësuara janë realiste, kriteri 3 i mësipërm, pra, është përmbushur. Në përputhje me SNK 37, marrja e policës së sigurimit për të kompenzuar çdo pretendim garancioni nuk duhet të justifikojë mosnjohjen e provizioneve. Çdo pasuri që mund të lindë nga polica e sigurimit duhet të kontabilizohet veçmas.

Në PPF më 31 dhjetor 2022, Ingenuity sh.a duhet të raportojë një detyrim aktual në lidhje me grancionin bazuar në numrin e njësive nga totali i njësive të shitjeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, i cili pritët të kthehet në të ardhmen. Kjo llogaritet si më poshtë:

|                                                                               |                 |
|-------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Kthimet totale të pritshme në lidhje me shitjet e vitit 2022 (3 milionë x 8%) | 240,000         |
| Minus njësitë që janë kthyer tashmë deri më 31 dhjetor 2022                   | <u>(20,000)</u> |
| Kthimet e pritshme të ardhshme (njësi)                                        | 220,000         |

Prandaj, detyrimi ndaj garancioneve për t'u raportuar në PPF më 31 dhjetor 2022 duhet të jetë €396,000 (dmth.  $220,000 \times €1,8$  për njësi).



Në PFHTTGJ për vitin deri më 31 dhjetor 2022 Ingenuity sh.a do të raportojë brenda kostove të saj operative në F/H një shpenzim që rrjedh nga ekzekutimi i garancioneve që përfshin sa vijon:

|                                                                              |                  |
|------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| Detyrimi ndaj provizionit me 31 dhjetor 2022                                 | 396,000          |
| Minus provizionet në fillim (nga 31 dhjetor 2021) 150,000(LI) x €1.8         | <u>(270,000)</u> |
| Rritja në provizionet                                                        | 126,000          |
| Rimbursimet e paguara për pretendimet në vitin 31 dhjetor 2022 20,000 x €1.8 | 36,000           |
| Kërkesat nga sigurimet në vitin 31 dhjetor 2022                              | <u>(36,000)</u>  |
| Ngarkesa në F/H në vitin 31 dhjetor 2022                                     | 126,000          |

Llogaritja – Kthimet e pritshme të ardhshme me 31 dhjetor 2021:

|                                                                                |                 |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Kthimet totale të pritshme në lidhje me shitjet e vitit 2021 (2 milionë x 10%) | 200,000         |
| Minus njësitë që janë kthyer tashmë deri më 31 dhjetor 2021                    | <u>(50,000)</u> |
| Njësitë për 2021                                                               | 150,000         |

3. a) Mariner sh.a është një kompani telekomunikacioni viti financiar i së cilës përfundon me 31 dhjetor 2022 që operon me një skemë pensionesh me përfitime të përcaktuara. Më 30 qershor 2022, kompania njoftoi se do të mbyllte një divizion biznesi dhe ra dakord t'i paguante secilit prej 500 punonjësve të saj një pagesë në para prej €50,000 për t'i kompensuar ata për humbjen e pensionit që rrjedh nga inflacioni i pagave. Vlerësohet se mbyllja do të ulë vlerën aktuale të detyrimit të pensionit me €6,000,000. Mariner sh.a nuk është e sigurt se si të merret me kompensimin dhe shkurtimin dhe nuk e ka regjistruar ende transaksionin në pasqyrat e saj financiare.

**Kërkohet:**

**Në përputhje me SNK 19 Përfitimet e punonjësve, tregoni trajtimin kontabël për transaksionin e mësipërm në pasqyrën financiare të Mariner sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022. (5 pikë)**

b) Nozomi sh.a bleu zyrën e saj qendrore me 1 janar 2013 me një kosto prej €10,000,000 (duke përfshirë tokën). Politika e Nozomi sh.a-së është të zhvlerësojë pasuritë e patundshme në baza drejtvizore përgjatë 50 viteve më vlerë të mbetur zero.

Me 31 dhjetor 2017 (pas pesë viteve të pronësisë) Nozomi sh.a rivlerësoi elementin jo-tokë të zyrës së saj qendrore në €12,000,000. Nozomi sh.a nuk transferon shumën vjetore nga teprica e rivlerësimit gjatë përdorimit të pasurive: kjo është në pajtim me trajtimin e lejuar në SNK 16, *Pasuritë e patundshme, impiantët e prodhimit dhe paisjet*.

Në dhjetor 2022 kreu një test të dëmtimit dhe shumën e rikuperueshme e elementit jo-tokë të zyrës qendrore ra në €6,200,000.

**Kërkohet:**

**Tregoni nëse zyra qendrore është e dëmtuar dhe llogariteni humbjen nga dëmtimi që duhet të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 në pajtim me SNK 36 Dëmtimi i pasurive. (5 pikë)**

c) Phobos sh.a për njësinë e saj të gjenerimit të parasë së gatshme e cila përmban fabrikën, impiantet e prodhimit, pajisjet ka këto vlera bartëse me 31 dhjetor 2019 para se të regjistrohet dëmtimi i këtyre pasurive:

Shumat bartëse me  
31 dhjetor 2019 (para dëmtimit)

|                                        |             |
|----------------------------------------|-------------|
| Zëri i mirë                            | 100,000,000 |
| Pasuritë e trupëzuara jo - qarkulluese | 100,000,000 |

Me 31 dhjetor 2019 Phobos sh.a kreu një test për dëmtim për këtë njësi gjeneruese të parasë për arsye se produktet që ajo prodhonte tashmë ia kanë lënë vendin një modeli më të avancuar teknologjik i cili prodhohet nga një konkurrent. Shuma e rikuperueshme e njësisë së gjenerimit të parasë së gatshme është vlerësuar në €60,000,000.

Pas tre vjetësh me 31 dhjetor 2022, kur vlera bartëse e pasurisë së trupëzuar jo-qarkulluese ishte €50,000,000 Phobos sh.a shpiku një risi të re teknologjike, dhe shumën e rikuperueshme e njësisë së gjenerimit të parasë së gatshme rritet dhe bëhet €140,000,000. Nëse nuk do të kishte ndodhur dëmtimi, shumën bartëse e pasurisë së trupëzuar jo - qarkulluese do të kishte qenë €80,000,000.

**Kërkohet:**

**Llogarisni humbjen nga dëmtimi për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2022.** (5 pikë)

**d) Në vijim janë dhënë informata për disa pasuri të Mars sh.a:**

- i. Një makineri kushton €100,000. Për qëllime tatimore, në periudhën aktuale dhe ato të mëparshme është zbritur tashmë zhvlerësimi me vlerë €40,000 dhe kostot që mbeten do të jenë të zbritshme në periudhat e ardhshme, ose në formën e zhvlerësimit ose nëpërmjet një zbritjeje të njëhershme kur makineria të largohet nga librat [kur shitet ose braktiset]. Të hyrat e gjeneruara prej përdorimit të makinerisë janë të tatueshme, të gjitha të ardhurat prej shitjes [largimit] të makinerisë do të jenë të tatueshme dhe të gjitha humbjet prej shitjes [largimit] do të jenë të zbritshme për qëllime tatimore.
- ii. Interesi i arkëtueshëm ka një vlerë bartëse prej €15,000. Të hyrat përkatëse nga interesi tatohen duke u bazuar mbi arkëtimet përkatëse të parasë së gatshme.
- iii. Të arkëtueshmet tregtare kanë një vlerë bartëse prej €25,000. Të hyrat përkatëse janë përfshirë tashmë në fitimin e tatueshëm (humbjen tatimore).
- iv. Një kredi e arkëtueshme ka një vlerë bartëse prej €250,000. Ri - pagimi i kredisë nuk do të ketë pasoja për tatimet.
- v. Dividendët e arkëtueshëm prej një filiali kanë një shumë bartëse prej €50,000. Dividendët nuk janë të tatueshëm.

**Kërkohet:**

**Tregoni bazën tatimore të secilës prej pasurive të mësipërme.** (5 pikë)

3.

a) Shlyerja e vlerësuar për detyrimin e pensionit është €25,000,000 (500 x €50,000) dhe duhet të përfshihet brenda detyrimeve afatshkurtra në pasqyrën e pozitës financiare.

Duke qenë se kjo është €19,000,000 më shumë se fitimet e vlerësuara të shkurtimit prej €6,000,000, një humbje prej €19,000,000 duhet të përfshihet në pasqyrën e të ardhurave. Detyrimet afatgjata zvogëlohen nga reduktimi i detyrimeve të pensioneve prej €6,000,000.

b) €1,470,000

SNK 36.60 dhe 61 (gjithashtu SNK 16.40) kërkojnë që një humbje nga dëmtimi që kthen mbrapsht një rivlerësim të mëhershëm duhet të njihet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse deri në shumën e tepricës së rivlerësimit për pasurinë e njejtë. Çdo shumë e mbetur njihet nëpërmjet fitimit apo humbjës. Andaj:

(a) Vlera bartëse me 31 dhjetor 2017 është  $45/50 \times €10,000,000 = €9,000,000$

(b) Teprica e krijuar e rivlerësimit është €3,000,000 (p.sh €12,000,000 – €9,000,000)

(c) Vlera bartëse me 31 dhjetor 2022 është  $40/45 \times €12,000,000 = €10,670,000$

(d) Shuma e rikuperueshme me 31 dhjetor 2022 është €6,200,000

(e) Total humbjet nga dëmtimi është €4,470,000 (€10,670,000 – €6,200,000)

(f) Nga këto, €3,000,000 është një kthim mbrapsht i tepricës së rivlerësimit, andaj vetëm €1,470,000 njihet të fitim dhe humbje.

c)

#### Regjistrimi i humbjes nga dëmtimi me 31 dhejtor 2019

|                                        | Shumat bartëse<br>para dëmtimit<br>€milion | Humbja<br>nga dëmtimi<br>€milion | Shumat bartëse<br>pas dëmtimit<br>€milion |
|----------------------------------------|--------------------------------------------|----------------------------------|-------------------------------------------|
| Zëri i mirë                            | 100                                        | (100)                            | -                                         |
| Pasuritë e trupëzuara jo - qarkulluese | <u>100</u>                                 | <u>(40)</u>                      | <u>60</u>                                 |
| <b>Totali</b>                          | <b>200</b>                                 | <b>(140)</b>                     | <b>60</b>                                 |

#### Regjistrimi i stornimit të humbjes nga dëmtimi me 31 dhejtor 2022

Stornimi i një humbjeje nga dëmtimet kontabilizohet për atë vlerë që rrit shumën bartëse të pasurisë jo - qarkulluese të trupëzuar, deri në atë vlerë që do të kishte qenë nëse nuk do të ishte regjistruar fare asnjë dëmtim. Pra, duhet të kontabilizohet stornimi i një humbjeje nga dëmtimet me vlerë €30,000,000 dhe pasuritë e trupëzuara jo - qarkulluese duhet të rimarrin vlerën që kishin prej €80,000,000. Stornimi i dëmtimit nuk kontabilizohet kurrë për pjesën që i takon zërit të mirë për arsye se efekti i ngjarjes së kaluar e cila shkaktoi dëmtimin origjinal nuk është stornuar – produkti origjinal mbetet [dhe do të mbetet] ende i zëvendësuar prej një modeli më të avancuar.

d)

- Baza tatimore e makinerisë është €60,000.
- Baza tatimore e interesit të arkëtueshëm është zero.
- Baza tatimore e të arkëtueshmeve tregtare është €25,000.

- iv. Baza tatimore e kredisë është €250,000.
- v. Baza tatimore e dividendëve është €50,000.

Në rastin e (v), në thelb e gjithë shuma bartëse e pasurisë është e zbritshme kundrejt përfitimeve ekonomike. Nuk ka diferenca të përkohshme të tatueshme. Një analizë alternative është që dividendët e arkëtueshëm të akruar kanë një bazë tatimore të barabartë me zero ndërsa zbatohet një normë e tatimit e barabartë me zero ndaj diferencave të përkohshme të tatueshme që dalin në pah (€50,000). Sipas të dyja analizave, nuk ka detyrim të tatimit të shtyrë.

#### 4.

Mars Pathfinder sh.a është një shitës me pakicë i pasijeve teknologjike dhe ka pika të shitjes në të gjithë Kosovën. Më 1 janar 2022, Mars Pathfinder sh.a mori lokale në një lizing katërvjeçar nga Sojourner sh.a, një kompani që zhvillon prona për t'u dhënë me qira ose për të shitur. Mars Pathfinder sh.a bëri ndryshime në lokale më 1 janar 2022 për të përmbushur kërkesat e saj të përdorimit përpara se të fillonte të përdorte lokalet me një kosto prej €50,000. Tarifat ligjore të paguara nga Mars Pathfinder sh.a ishin €120,000. Lizingu kërkon që këto ndryshime të kthehen siç kanë qenë në fillim në fund të afatit të lizingut dhe lokalet të rikthehen në gjendjen e tyre origjinale. Mars Pathfinder sh.a ka vlerësuar se vlera e tanishme (më 1 janar 2022) e kostos së restaurimit (kthimit në gjendjen e mëparshme) është €200,000 pas skontimit me një normë prej 8%. Pagesat e lizingut nga Mars Pathfinder sh.a (e pagueshme në fund të çdo viti të lizingut) do të jetë €500,000 për dy vitet e para dhe €600,000 për dy (2) vitet e fundit. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing është 8%.

Lokalet të cilat nga Sojourner sh.a, i janë dhënë me lizing Mars Pathfinder sh.a-së janë blerë më 1 janar 2018 me një kosto totale prej €20,000,000 (përfshirë €10,000,000 për tokën). Ato u rivlerësuan për herë të fundit më 31 dhjetor 2021 në një vlerë të drejtë prej €22,000,000 (përfshirë €11,000,000 për tokën). Sojourner sh.a ende nuk e ka rivlerësuar pronën në 31 dhjetor 2022 në vlerën e drejtë prej €21,000,000 (duke përfshirë €9,000,000 për tokën). Prona ka një jetëgjatësi totale prej 30 vjetësh. Sojourner sh.a përdor modelin e kostos së pronave investuese sipas SNK 40 *Investimi në pasuri të patundshme*. Sojourner sh.a përdor modelin e rivlerësimit të SNK 16 *Prona, impiantet dhe pajisjet* në kontabilitetin për pronat e zotëruara nga pronari.

Më 1 janar 2022, Mars Pathfinder sh.a i shiti një ndërtesë një pale të tretë me një çmim prej €15,000,000, kur vlera e drejtë e ndërtesës ishte €30,000,000. Ndërtesa, jeta totale e dobishme ekonomike e përlllogaritur e së cilës është 50 vjet, u ble më 1 janar 2012 me një kosto prej €25,000,000. Megjithatë, Mars Pathfinder sh.a ka lidhur një kontratë për marrjen me qira të ndërtesës nga pronari i ri gjatë jetës së saj të mbetur prej 40 vjetësh me një qira vjetore prej €1,257,861 në vit, e cila duhet të paguhet më 31 dhjetor të çdo viti gjatë afatit të qirasë. Mars Pathfinder sh.a përdor modelin e kostos të SNK 16 *Prona, impiantet dhe pajisjet* në kontabilizimin e pronave. Norma inkrementale e huazimit të Mars Pathfinder sh.a është 8%. Faktori që duhet përdorur për një anuitet prej 8% për 40 vitesh është 11.925.

FS @ 8%

|        |        |
|--------|--------|
| Viti 1 | 0.9259 |
| Viti 2 | 0.8573 |
| Viti 3 | 0.7938 |
| Viti 4 | 0.7350 |

#### Kërkohe:

- (a) Shpjegoni shkurtimisht se si qiradhënësit duhet të kontabilizojnë lizingjet brenda fushëveprimit të SNRF 16 *Lizingjet*. (3 pikë)
- (b) Shpjegoni se si Mars Pathfinder sh.a duhet të kontabilizoj kontratën e lizingut me Sojourner sh.a në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022, në përputhje me SNRF-të. (5 pikë)

- (c) Shpjegoni se si Sojourner sh.a duhet të kontabilizoj lizingun dhe pronën që i është dhënë me lizing Mars Pathfinder sh.a-së në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022, në përputhje me SNRF-të. (7 pikë)
- (d) Shpjegoni se si Mars Pathfinder sh.a duhet të kontabilizoj shitjen dhe marrjen përsëri me qira të ndërtesës në përputhje me kornizën e SNRF-ve. (5 pikë)

(a)

Qiradhënësit do të klasifikojnë çdo lizing si një lizing operativ ose një lizing financiar.

Një lizing klasifikohet si një lizing financiar nëse transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e një pasurie themelore. Përndryshe, lizingu klasifikohet si lizing operativ.

Shembuj të situatave që individualisht ose në kombinim normalisht do të çonin në klasifikimin e një lizingu si lizing financiar janë:

- lizingu transferon pronësinë e pasurisë tek qiramarrësi deri në fund të afatit të lizingut.
- qiramarrësi ka opsionin për të blerë pasurinë me një çmim që pritet të jetë mjaftueshëm më i ulët se vlera e drejtë në datën kur opsioni bëhet i ushtrueshëm, kështu që, në fillimin e lizingut, është mjaft e sigurt që opsioni do të ushtrohet.
- Afati i lizingut është për pjesën më të madhe të jetës ekonomike të pasurisë, edhe nëse titulli nuk është transferuar.
- në fillimin e lizingut, vlera e tanishme e pagesave minimale të lizingut përbën të paktën në thelb të gjithë vlerën e drejtë të pasurisë të dhënë me lizing.
- Pasuritë e dhëna me qira janë të një natyre të specializuar të tillë që vetëm qiramarrësi mund t'i përdorë ato pa bërë modifikime të mëdha.

Me fillimin e lizingut, qiradhënësi do të njohë pasuritë e mbajtura nën një lizing financiar si të arkëtueshme në një shumë të barabartë me investimin neto në lizing.

Qiradhënësi njeh të ardhurat financiare gjatë afatit të lizingut të një lizingu financiar, bazuar në një model që pasqyron një normë konstante periodike kthimi mbi investimin neto.

Në datën e fillimit, një prodhues ose tregtar njeh më pak ose më pak fitim ose humbje nga shitja në përputhje me politikën e tij për shitjet e plota për të cilat zbatohet SNRF 15.

Qiradhënësi njeh pagesat e lizingut operativ si të ardhura mbi bazën lineare ose një bazë tjetër sistematike, nëse është më përfaqësuese e modelit në të cilin përfitimi nga përdorimi i pasurisë themelore zvogëlohet.



(b)

Mars Pathfinder sh.a duhet të kapitalizojë lizingun duke njohur pasurinë me të drejtën e përdorimit dhe detyrimet e lizingut. Mars Pathfinder sh.a duhet të njohë gjithashtu një provizion në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente* në lidhje me detyrimin për të anuluar ndryshimet në fund të afatit të lizingut.

| 1. Detyrimi ndaj lizingut:                                                      | €                |
|---------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| Detyrimi në fillim (VT e PML)                                                   | 1,808,880        |
| Kosto financiare që do të ngarkohet ne F/H për 2022 ( $10\% \times 1,808,880$ ) | 180,888          |
| Qiraja e paguar me 31 dhjetor 2022                                              | <u>(500,000)</u> |
| Total detyrimi ndaj lizingut me 31 dhjetor 2022                                 | 1,489,768        |
| Pjesa afatgjatë $1,489,768 \times 1.1 - 500,000$                                | 1,138,744.8      |
| Pjesa afatshkurt (saldo) $(1,489,768 - 1,138,744.8)$                            | 351,023.2        |

**2. Provizion për restaurimi (anulimin e ndryshimeve)**

|                                                                                |               |
|--------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| Vlera bartëse ne fillim (VT me 1 janar 2022)                                   | 200,000       |
| Anulimi i skontimit në F/H për v/p me 31 dhjetor 2022 ( $8\% \times 200,000$ ) | <u>16,000</u> |
| Vlera bartëse me 31 dhjetor 2022 në PPF                                        | 216,000       |

**3. Pasuria me të drejtën e përdorimit**

|                                                   |                  |
|---------------------------------------------------|------------------|
| Pagesat (kostot) në para me 1 janar 2022:         |                  |
| - Ndryshime në lokale                             | 50,000           |
| - Tarifat ligjore                                 | <u>200,000</u>   |
|                                                   | 270,000          |
| Detyrimi në fillim ndaj lizingut                  | 1,808,880        |
| Provizioni fillestar për kostot e restaurimit     | 200,000          |
| Vlera bartëse ne fillim me 1 janar 2022           | 2,278,880        |
| Zhvlerësimi në F/H për vitin 2022 $(2,278,880/4)$ | <u>(569,720)</u> |
| Vlera bartëse me 31 dhjetor 2022 në PPF           | 1,709,160        |

**Llogaritjet**

Vlera e tanishme e pageave minimale te lizingut

|        | FS@8%  | Shuma   | VT               |
|--------|--------|---------|------------------|
| Viti 1 | 0.9259 | 500,000 | 462,950          |
| Viti 2 | 0.8573 | 500,000 | 428,650          |
| Viti 3 | 0.7938 | 600,000 | 476,280          |
| Viti 4 | 0.7350 | 600,000 | <u>441,000</u>   |
|        |        |         | <b>1,808,880</b> |

(c)

Kontabilizimi nga qiradhënësi:

Qiraja është një lizing operativ. Afati i qirasë prej 4 vjetësh është një pjesë shumë e vogël e jetës totale të dobishme ekonomike të lokaleve (30 vjet). Prandaj, Sojourner sh.a do të vazhdojë të kontabilizoj pronësinë e loakaleve si një pronë investuese në përputhje me SNK 40 *Investimi në pasuri të patundshme* dhe duhet të njohë totalin pagesave minimale të lizingut si të ardhura gjatë afatit të qirasë në bazë lineare në përputhje me SNRF 16 *Lizingjet* si më poshtë:

|                                                                                 | €                  |
|---------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Total pagesat e lizingut (2 x €500,000 + 2x €600,000)                           | 2,200,000          |
| Të hyrat nga qiraja për vitin 2022 (2,200,000 / 4 vite)                         | 550,000            |
| Paraja e pranuar deri me 31 dhjetor 2022                                        | <u>(500,000)</u>   |
| Te hyrat e shtyrea në PPF me 31 dhjetor 2022                                    | 50,000             |
| Kontabilizimi i lokaleve:                                                       |                    |
| Vlera bartëse me 1 janar 2022                                                   | 22,000,000         |
| Zhvlerësimi për vitin 2022 ((22,000,000 -11,000,000) / 26 vite të mbetura)      | <u>(423,077)</u>   |
| Vlera bartëse me 31 dhjetor 2022 para rivlerësimit                              | 21,576,923         |
| Humbja nga rënia me vlerë në vitin 2022                                         | <u>(576,923)</u>   |
| VD e raportuar me 31 dhjetor 2022 në PPF                                        | 21,000,000         |
| Raportimi i humbjes:                                                            |                    |
| Vlera bartëse sipas modelit të kotos me 31 dhjetor 2022 =                       | 20,000,000         |
| Zhvlerësimi i akumuluar 20,000,000-10,000,000 = 10,000,000 / 30 vite x 5 vite = | <u>(1,666,667)</u> |
|                                                                                 | 18,333,333         |

E gjithë humbja është një anulim i pjesshëm i një perfitimi nga rivlerësimi në të kaluarën Prandaj e gjithë humbja do të raportohet në TTGJ për vitin deri më 2022.

(d)

Shitja në transaksionin Transaksionet shite - dhe - merre - përsëri - me - qira nuk e ka substancën tregtare si shitje në përputhje me SNRF 15. Shitësi Mars Pathfinder sh.a nuk ka transferuar në thelb të gjitha përfitimet dhe rreziqet ekonomike që lidhen me pronësinë e ndërtesës ashtu siç do vazhdojnë të nxjerrin përfitime ekonomike të mishëruara në ndërtesë gjatë gjithë jetës së mbetur të ndërtesës edhe pse nëpërmjet qiradhënies. Prandaj, Mars Pathfinder sh.a duhet të vazhdojë të kontabilizoj pronësinë e pasurisë. Thelbi i transaksionit duket të jetë një marrëveshje financimi përmes së cilës Mars Pathfinder sh.a ka marrë në mënyrë efektive një hua të barabartë me të ardhurat e supozuara të nxjerrjes jashtë përdorimit duke lënë peng pasurinë si garanci. Qiratë përfaqësojnë kështu e shlyerjes së kredisë. Shumat për raportim në pasqyrat financiare të Mars Pathfinder sh.a për vitin deri më 31 dhjetor 2022 janë si më poshtë:

|                                                                 | €                |
|-----------------------------------------------------------------|------------------|
| Ndërtesa:                                                       |                  |
| Vlera bartëse me 1 janar 2022 (25,000,000 - 25,000,000/50 x 10) | 20,000,000       |
| Zhvlerësimi për vitin 2022 (25,000,000/50)                      | <u>(500,000)</u> |
| Vlera bartëse me 31 dhjetor 2022                                | 19,500,000       |

Kredia:

|                                                                  |                    |
|------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Detyrimi në fillim 1 janar 2022                                  | 15,000,000         |
| Kosto financiare në F/H për vitin 2022 $(15,000,000 \times 8\%)$ | 1,200,000          |
| Pagesa e kredisë (qirasë)                                        | <u>(1,257,861)</u> |
| Vlera bartëse në PPF me 31 dhjetor 2022                          | 19,942,139         |

5.

a) Më 1 janar 2022, Tianwen-3 sh.a emetoi 1 milion nota të kreditit më vlerë nominale prej €100 secila me normë të interesit prej 10%. Kostot e emetimit arritën në 1% të të ardhurave bruto të emetimit. Norma e përgjithshme e interesit të tregut më 1 janar 2022 ishte 10% (dhe ishte gjithashtu e barabartë me normën e interesit specifike për Tianwen-3 sh.a duke reflektuar vlerësimin kreditor të kompanisë). Notat e kreditit paguajnë interes në 31 dhjetor të çdo viti gjatë afatit të tyre dhe janë të riblershme në vlerë nominale më 31 dhjetor 2024. Emetimi kishte për qëllim financimin e një portofoli të pasurive investuese, kthimet e të cilave zakonisht vlerësohen duke iu referuar ndryshimeve në vlerën e drejtë. Rrjedhimisht, për të shmangur një mospërputhje kontabël ose bazë matjeje për ato pasuri dhe detyrimin ndaj notave të kreditit, Tianwen-3 sh.a i ka përcaktuar notat e kreditit si vlera e drejtë përmes profitit ose humbjes në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Vlera e drejtë (pas pagesës së interesit të arritur në atë datë) për çdo notë të kreditit më 31 dhjetor 2022 ishte €103 ndërsa norma e përgjithshme e interesit të tregut në atë datë ishte 11%.

|        | Faktori i skontimit me 10% | Faktori i skontimit me 11% |
|--------|----------------------------|----------------------------|
| Viti 1 | 0.9091                     | 0.9009                     |
| Viti 2 | 0.8264                     | 0.8116                     |
| Viti 3 | 0.7513                     | 0.7312                     |

**Kërkohet:**

**Tregoni se si Tianwen-3 sh.a duhet të raportoj notën e mësipërme të kreditit në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare* në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022.** (10 pikë)

b) Spirit sh.a ka pasur humbje përgjatë disa viteve të fundit. Pasqyra e saj e pozitës financiare me 31 dhjetor 2022 tregonte të më poshtmet.

|                            | €              |                 | €              |
|----------------------------|----------------|-----------------|----------------|
| Kapitali aksionar          | 50,000         | Impianti        | 50,000         |
| Fitimet e mbajtura         | (100,000)      | Stoqet          | 20,000         |
| Nota e kreditit (siguruar) | 90,000         | Të arkëtueshmet | <u>30,000</u>  |
| Të pagueshmet              | <u>60,000</u>  |                 |                |
|                            | <b>100,000</b> |                 | <b>100,000</b> |

Në likuidim, pasuritë do të realizonin si vijon.

|                 | €             |
|-----------------|---------------|
| Impianti        | 25,000        |
| Stoqet          | 10,000        |
| Të arkëtueshmet | <u>20,000</u> |
|                 | <b>55,000</b> |

Nëse kompania do të vazhdonte të tregtonte për katër vitet e ardhshme, fitimet pas ngarkesës vjetorë të zhvlerësimit prej €12,500 për impiantin do të ishte si vijon.

|      | €             |
|------|---------------|
| 2023 | 25,000        |
| 2024 | 19,000        |
| 2025 | 22,000        |
| 2026 | <u>24,000</u> |
|      | <b>90,000</b> |

**Kërkohet:**

**Duke supozuar se nuk do të kishte tepricë të parasë për të paguar kreditorët dhe mbajtësit e notës së kreditit deri pas katër viteve dhe që stoqet dhe të arkëtueshmet më pastaj mund të realizohen sipas vlerës së tyre të librave, kërkohet nga ju të përgaditni një skemë të rikonstruktimit të Spirit sh.a. Injoro tatimin.**

**(10 pikë)**

a) Tianwen-3 sh.a i ka klasifikuar notat e kreditit si një detyrim - vlera e drejtë përmes profitit ose humbjes. Prandaj ato do të maten fillimisht, më 1 janar 2022, me vlerën e tyre të drejtë prej €100 për notë të kreditit, duke përjashtuar kostot e transaksionit në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Kostot e transaksionit prej  $1\% \times 1,000,000 \times €100 = €1,000,000$  do të shpenzohen në F/H për vitin kur është lidhur kontrata pra 31 dhjetor 2022.

Më pas, detyrimi ndaj notave të kreditit do të rimatet me vlerën e tyre të drejtë në çdo datë raportimi. Prandaj më 31 dhjetor 2022, vlera kontabël e tyre në PPF do të jetë €103,000,000 (dmth. €103 për notë të kreditit x 1 milionë nota të kreditit). Fitimet dhe humbjet nga rimatja raportohen kryesisht në F/H. Megjithatë, çdo fitim ose humbje nga rimatja që lind nga ndryshimet në vlerësimin kreditor të Tianwen-3 sh.a raportohet në TTGJ.

Prandaj, shumat për t'u raportuar në PFHTTGJ për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 do të jenë si më poshtë:

| <b>Pasqyra e fitimit ose humbjes</b>                                                   |                |
|----------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
|                                                                                        | <b>€'000</b>   |
| Kostot e transaksionit ( $1\% \times €100 \times 1,000,000$ nota të kreditit)          | (1,000)        |
| Kosto financiare në vlerën bartëse gjatë vitit ( $€100 \times 1,000,000 \times 10\%$ ) | (10,000)       |
| Humbja nga rimatja për vitin (LI 3)                                                    | <u>(1,715)</u> |
| Neto humbja në detyrimin sipas VDPFH                                                   | (12,715)       |

| <b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</b> |         |
|--------------------------------------------|---------|
| Humbjet nga rimatja për vitin (LI 4)       | (1,285) |

#### **Llogaritjet:**

|                                                                              | <b>€'000</b>     |
|------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| <b>1. Fitimi ose humbja totale e rimatjes në notat e kreditit për vitin:</b> |                  |
| Vlera e drejtë në fund të vitit                                              | 103,000          |
| Minus vlera bartëse para rimatjes:                                           |                  |
| Vlera bartëse në fillim                                                      | 100,000          |
| Kosto financiare për vitin                                                   | 10,000           |
| Paraja e paguar me 31 dhjetor 2022 ( $10\% \times €100,000$ )                | <u>(10,000)</u>  |
|                                                                              | <u>(100,000)</u> |
| Total humbja nga rimatja me 31 dhjetor 2022                                  | 3,000            |

#### **2. Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2022 pa ndryshimin në vlerësimin kreditor:**

Vlera e drejtë e notave të kredit në datën e emetimit 1 janar 2022 është e barabartë me vlerën nominale pasi që norma e interesit të notave të kreditit është e barabartë me normën e interesit që mbizotëron në treg.

Në datën e raportimit me 31 dhjetor 2022 vlera e drejtë pa ndryshimin në vlerësimin kreditor është vlera e rrjedhave të parasë të skontuara me normën e interesit që mbizotëron në treg prej 11% dhe është e barabartë me €98,285,000 ( $9,009,000 + 89,276,000$ ).

| <b>Data</b>     | <b>Rrjedhat e parasë (€'000)</b> | <b>FS @ 11%</b> | <b>VT (€'000)</b> |
|-----------------|----------------------------------|-----------------|-------------------|
| 31 dhjetor 2023 | 10,000                           | 0.9009          | 9,009             |
| 31 dhjetor 2024 | 110,000                          | 0.8116          | 89,276            |

**3. Fitimi i rimatjes për shkak të ndryshimeve të përgjithshme në normat e interesit të tregut (shuma që duhet të raportohet në F/H):**

|                                                                                 |                  |
|---------------------------------------------------------------------------------|------------------|
|                                                                                 | €'000            |
| Vlera e drejtë me 31 dhejtor 2022                                               | 98,285           |
| Vlera bartëse para rimatjes                                                     | <u>(100,000)</u> |
| Humbja për shkak të ndryshimeve të përgjithshme në normat e interesit të tregut | (1,715)          |

**4. Humbje nga rimatja për shkak të ndryshimeve (norma specifike e interesit) në vlerësimin kreditor:**

|                                                                                 |                |
|---------------------------------------------------------------------------------|----------------|
|                                                                                 | €'000          |
| Total humbja e rimatjes                                                         | 3,000          |
| Humbja për shkak të ndryshimeve të përgjithshme në normat e interesit të tregut | <u>(1,715)</u> |
| Humbje nga rimatja për shkak të ndryshimeve në vlerësimin kreditor              | 1,285          |

**b)**

Nëse likuidimi do të ndodhte tani vetëm €55,000 do të nxjerrëshin të cilat do tu jipeshin mbajtësve të notës së krediti duke i lënë ata më një deficit prej €35,000. Nuk do të kishte asgjë për kreditorët dhe aksionarët. Megjithatë, nëse tregtimi do të vazhdonte për katër vitet e ardhshme dhe rezultatet e vlerësuar arrihen, paraja në dispozicion do të ishte si vijon.

|                                           |                |
|-------------------------------------------|----------------|
|                                           | €              |
| Fitimet                                   | 90,000         |
| Zhvlerësimi                               | 50,000         |
| Stoqet dhe të arkëtueshmet: vlera e plotë | <u>50,000</u>  |
|                                           | <b>190,000</b> |

€190,000 do të mundësonin që mbajtësit e notës së kreditit dhe kreditorët të paguhën në tërësi duke lënë €40,000 në dispozicion të aksionarëve të zakonshëm.

Çdonjëri do të ishte më mirë nëse kompania do të lejohej të vazhdonte të tregtonte. Megjithatë, mbajtësit e notës së kreditit mesiguri se do të kishin të drejtën të caktonin një likuidator dhe do të insistonin në ndonjë kompensim për mos ushtrimin e të drejtës së tyre.

Kreditorët gjithashtu mund të presin diçka për shkak se duhet të presin katër vite para së të pranojnë ndonjë pagesë.

Nuk ka zgjidhje unike në një pyetje të tillë, por njëra që mund të ishte e pranueshme është që mbajtësit e notës së kreditit dhe kreditorët të heqnin dorë nga shumat që u janë borxh në këmbim të aksioneve të zakonshme, ashtu që ta atë kenë pjesëmarrje të plotë në profitabilitetin e ardhshëm të kompanisë. Kushtet e një këmbimi të tillë mund të jenë si në vijim.

(a) 70,000 x €1 aksione të zakonshme për mbajtësit e notës së kreditit (7 x €1 aksione të zakonshme €1 për çdo €9 të notës së kreditit)

(b) 20,000 x €1 aksione të zakonshme për kreditorët (1 x €1 aksion të zakonshëm për çdo €3 borxh)

(c) 10,000 x €1 aksione të zakonshme për aksionarët e vjetër të zakonshëm (1 x €1 aksion të zakonshëm për çdo 5 aksione të zakonshme të vjetra)

Kreditorët mund të preferojnë të pranojnë notë krediti pasi që mund të kenë të drejtën ligjore në pagesën e shumës nominale të kapitalit dhe mund të insistojnë në pagesën e interesit.

Pasqyra e rikonstruktuar e pozitës financiare të Spirit sh.a me 31 dhjetor 2022 do të ishte si në vijim.

|                   | €              |                 | €              |
|-------------------|----------------|-----------------|----------------|
| Kapitali aksionar | 100,000        | Impianti        | 50,000         |
|                   |                | Stoqet          | 20,000         |
|                   |                | Të arkëtueshmët | <u>30,000</u>  |
|                   | <b>100,000</b> |                 | <b>100,000</b> |